



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:208183
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05502538

C.nr. 248/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridiko kontestimore të paditëses: B.K e S në P – BKS, përfaqësuar nga M.K, kundër të paditurit Xh.M nga M, përfaqësuar nga A.M nga M, Baza juridike: Rimbursim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit: 725.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesorë të dt. 19.03.2024 në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, jashtë seance me dt. 26.03.2024 nxjerr këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR kërkesë padia e paditëses: B.K.S, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** i padituri: Xh.M nga M, që paditëses B.K të S t'ia rimburoj shumën prej; 725.00 Euro si pasoj e aksidentit të trafikut të datës: 07.12.2012 në Fsh. D. K-I, me kamat ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e ngritjes së padisë 02.05.2017 e deri në pagesën përfundimtare si dhe ti paguaj edhe shpenzimet gjyqësore në emër të taksës gjyqësore, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET paditësja BKS , Rr. ‘L.P’, Magj. P – F.K, pa. nr., që të ia paguajë shpenzimet e procedurës të paditurit në shumën prej: 150 euro, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datë: 02.05.2017 ka ushtruar padi kundër të për rimbursim dëmi material dhe jo material, me vlerë kontesti: 725.00euro.

I autorizuari i paditëses me padi dhe në fjalën përfundimtare si dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës: 07.12.2012 në Fsh. D.K- I, të detyrohet i padituri pagesën e shumës prej 725.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga ushtrimi i padisë e deri në pagesën definitive të detyrimit, duke shtuar se kërkimi i mjeteve në shumë prej: 725 euro për shkak të rimbursimit nga dëmi i shkaktuar në aksidentin e sipër cekur, i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur mbulesë sigurimi, dhe pas administrimit të provave në shkresa të lëndës dhe në bazë të ekspertizës së komunikacionot vërtetohet shkaktari kryesor i aksidentit, andaj ka kërkuar nga gjykata ta provoj në tersi si të bazuar kërkesëpadinë pasi që në bazë të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, janë të obliguar të kompensojnë palët demin e shkaktuar në aksidentin kur nuk kanë mbulesë siguroese dhe ka kompensuar personin e tretë, andaj në bazë të dispozitave të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia, i nenit 18, BKS- ja ka të drejtë të kërkoj rimbursimin e dëmit nga shkaktari i pasiguar mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet i padituri

që paditëses BKS, ti rimbursoi shumën prej: 725,00 Euro, në emër të rimbursimit të demit të shkaktuar në aksidenti e trafikut të datës: 07.12.2012 dhe atë me kamata ligjore nga ushtrimi i padisë si dhe shpenzimet e procedurës për taksen gjyqësore.

I padituri në përgjigjen e dhen me shkrim në padi dhe në fjalën përfundimtare nëpërmjet të autorizuarit të tij ka deklaruar se e kundërshtoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, nga baza e parashkrimit – vjetërsimit të kërkesës për realizimin të kompensimit – rimbursimit në rrugë gjyqësore, pasi ka kaluar afati ligjor brenda të cilit do të kishte mund të kërkohej dhe realizohet një kërkesë e tillë, ashtu siç parashihet në dispozitat e LMD-së, me tutje në përgjigje në padi i padituri ka deklaruar se në rastin në fjalë kanë kaluar me shumë se 3 (tre) nga data e pajtimit jashtë gjyqësore te dt. 11.11.2023 kurs padia është paraqitur me dt. 02.05.2017, kanë kaluar me shumë se 3 (tre) vite dhe atëherë kemi parashkrim, e duke u mbështetur në dispozita e LMD-së, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet padi dhe kërkesëpadia e paditëse në kuptim të theksimeve si në përgjigje në padi, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në emër të ekspertizës së komunikacionit shumen prej 150 euro.

Gjykata ka nxjerr provën me ane të ekspertizës së komunikacionit, për të përcaktuar shkaktarin e aksidentit, ku eksperti i komunikacionit me dt. 09.02.2024 ka konstatuar se shkaktar i aksidentit është Xh.M.

Gjykata në këtë çështje kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat materiale: Dosja e demit me numër 1606/13, Urdhër transferi Bankar i datës 18.11.2013, Ujdia jashtëgjysore e datës 11.11.2013, Vendimi dt. 06.11.2013, Vendimi i Komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve e dt. 29.10.2013, Formulari për kompensimin e demit jo material e dt. 29.11.2013, Vlerësimi mjekësor dt. 07.12.2012, Mendimi i Komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve dt. 14.03.2013 dhe 05.02.2013, Raporti policor i dt. 07.12.2012, Fotografit e veturës së dëmtuar, Procesverbali në vendin e aksidentit dt. 07.12.2012 së bashku me 19 fotografi të vendin të ngjarjes, Raporti mjekësor i Spitalit Regjional ne Peje lëshuar ne emër te L.L dt. 19.08.2013, Konfirmimi i sigurimit i datës 06.05.2011 dhe Ekspertiza e komunikacionit e datës 09.02.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, e në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara përkatësisht nga Raportet fillestar i Policisë, GR-3004-1987-12 i datë: 07.12.2012, dhe 19 fotot nga vendi i ngjarjes, si deh nga ekspertiza e kounikacionit e dt. 09.02.2024, gjykata ka konstatuar se me datën: 07.12.2012, në orën 10:10 min, në rrugën regjionale Mitrovicë-Pejë konkretisht e fsh. D.K e I, i padituri Xh.M nga M, duke drejtuar automjetin, AUDI, e pa nr te targave, ka shkaktuar aksident trafiku, si pasoj e mos mbajtjes se distancës dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me pjese e përparme ballore e godet automjetin B dhe ku automjeti B e godet qerren e kuajve, duke i shkaktuar dëm material në automjet.

I padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit të automjetit ne fjalë nuk posedonte sigurimi, dhe regjistrim.

I dëmtuari L.Ll nga I, për këtë aksident në procedurë jashtë - gjyqësore, me paditësen BKS, ka arritur ujdë jashtë - gjyqësore, me nr. 1606/2013 e datës 11.11.2013, dhe urdhër transferi i datës 18.11.2013.

Me shikimin dhe leximin Ujdisë jashtëgjyqësore nr. 1606/2013 e datës 11.11.2013, si dhe nga urdhër transferit nga BKS të datës: 18.11.2013, të cilave gjykata ju fali besimin, gjykata ka konstatuar se të dëmtuarit L.Ll nga I, nga këtu paditësja ka realizuar rimbursimin të dëmit materialë dhe jo material në shumën prej: 725.00€.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare si kontestuese në mes palëve ka gjetur rrethanën se a është padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, një padi e parashkruar apo jo.

Me dispozitën e LMD në nenin: 357, par.1, ka përcaktuar “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për tri (3) vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”. Andaj në kuptim të kësaj dispozitë ligjore gjykata ka ardhur në përfundim së kërkesëpadija e paditëse është e pabazuar për shkak së është e parashkruar, pasi që njëjta është paraqitur pas afatit ligjor, pasi që ujdia jashtëgjyqësore është lidhur me datë: 11.11.2013, ku e dëmtuara (paditësja) është vënë në dijeni për dëmin dhe dëmtuesin (të paditurin), si dhe Urdhër transferi i Banës i datës : 18.11.2023, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykatë me datë: 02.05.2017, përkatësisht pas 3 viteve, duke llogaritur nga dita e Urdhër transferit Bnkar i datës 18.11.2013 kur paditësja (e dëmtuara) është vënë ne dijen për dëmin dhe të dëmtuarin (të paditurin), ndërsa padia është dashur të ushtrohet brenda 3 vjetëve, andaj gjykata vendosi si ne piken I te dispozitivit te këtij aktgjykimi konform nenit 357 par. 1 të LMD-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera shkresor në lëndë si dhe pretendimet tjera të palëve në procedurë, mirëpo nuk u lëshuar në arsyeshmërin e tyre, sepse konsideroj se nuk do të ishim me ndikim për një vendim me ndryshe.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 449, nenit 452 par. 1, nenit 463 e lidhur me nenin 485.1 të LPK-së, ashtu që e detyroj paditsen, që të paditurit të ja kompensoj në emër te shpenzimeve procedurale shumen prej 150 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoj në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.248/2017, datë: 26.03.2024

G j y q t a r i,
Blerim Istrefi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh ,nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.